

R A P O R T
I
AUDITUSIT TË PAVARUR
për

FONDET E PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA
NGA PARTIA REPUBLIKANE

NË FUSHATËN E ZGJEDHJEVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE ,
(8 MAJ 2011)

Drejtuar : - KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE
- PARTISË REPUBLIKANE TË SHQIPËRISË
TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Bazuar në vendimin Nr.1232, datë 07.11.2011 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve si dhe në Kontratën e Shërbimit datë 16.11.2011 të lidhur me këtë institucion kryem auditimin e pasqyrave financiare, bashkelidhur, për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Republikane gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, të zhvilluar më 8 Maj 2011.

Pergjegjesia e Drejtimit te Partisë Republikane

Përgatitja e Pasqyrave Financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Republikane gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore është përgjegjësi e drejtimit të saj.

Pergjegjesia e Audituesit

Përgjegjësia e Audituesit është të shprehë një opinion mbi këto pasqyra, bazuar në auditimin e kryer në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit , në koherencë të plotë me SNA 800 (Mbi angazhimet e auditimit për qëllimet e veçanta).

Këto standarte kërkojnë që auditimi të planifikohet dhe të kryhet për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve e dokumenteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në Pasqyrat Financiare të deklaruara.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve kontabile të ndjekura, vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlersimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave të fondeve të arkëtuara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore

Ne çmojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë mbi Pasqyrat Financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Republikane gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, të zhvilluar më 8 Maj 2011.

Opinionin :

Bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Republikane gjatë fushatës zgjedhore të organeve të qeverisjes vendore, zhvilluar më datën 8 Maj 2011, japin një pamje të vërtetë e të sinqertë të.

Tiranë, më 14.01.2012

Ahmet STOJNA

Ekspert Kontabël i Regjistruar
Nr. 6 i Regjistrimit Publik të IEKA-s

Adresa: Rruga e Elbasanit, P."Radovani" Nr.5/5 Tirane
Tel 2468748 Mob 0684040661
E-mail : ahmetstojna@yahoo.com

PERMBAJTJA

RAPORTI I VEÇANTE I AUDITIT TE PA VARUR

I . INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

II. MARJA E MISIONIT

III .PASQYRA E TE ARDHURAVE (Financimet dheDonacionet)

IV .PASQYRA E SHPENZIMEVE (Perdorimi i fondeve sipas destinacionit)

Referencat ligjore:

Per kryerjen e ketij misioni jemi mbeshtetur ne perputhje me ;

- Standartet Nderkombetare te Auditimit me reference te veçante SNA 800.
- Ligjin nr.10019.date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise"
- Ligjin nr.10091date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe te Kontabilistit te Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 „Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare“
- Cdo dokument ligjor te mare prane Partise Republikane

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor « Partia Republikane » e ka fituar zotesine juridike per te vepruar , me vendim Nr.16/2 date 10.01.1991te Gjykates se Rrethit Tirane. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr. 8788 date 07.05.2001 “Per Organizatat Jofitimpruese » te Ligjit 8779 date 07.05.2001 »Per Rregjistrimi e Organizatave Jofitimpruese », nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi.

Subjekti zgjedhor partia Republikane eshte nje organizate shqiptare e cila e ushon veprimtarine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise. Kapitalit themeltar i Qendres eshte shuma pej 100.000 leke (njqindmije) Qendra e shoqerise eshte ne rrugen « Abdi Toptani», Tirane. Kjo shoqeri eshte rregjistruar prane organeve tatimore te rrethit Tirane me numer Nipti K 52428003 L

Objekti i veprimtarise :

Qellimi i Partise Republikane eshte te forcoje eksperiencen politike demokratike ne Shqiperi duke promovuar vlera demokratike.

Burimet e financimit jane :

-Buxheti i Shtetit 10 695 140 leke

-Donacionet dhe dhuratat. 500 000 leke.

-Si dhe burime te tjera te ligjshme sipas legjislacionit shqiptar. Zero.(0)

Te gjitha burimet financiare do te perdoren drejtpersedrejti per te realizuar qellimet dhe objektivat e subjektit zgjedhor

Organet drejtuese te Qendres jane :

keshilli Drejtues ;

Kryetari

Kryetar eshtezgjedhur **Z.Fatmir Mediu** ,i cili eshte autorizuar te ndjeke te gjitha procedutat e nevojshme per aktivitetin normal te «Partise Republikane »

1. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

a. Menyra e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare jane pregatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me Normat Kombetare te Raportimit Financiar (NKRF), te cilat perfshijne rregullat e percaktuara ne ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 „Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare“ dhe „Planin Unik Kontabel“, te miratuar me vendim te Keshillit te Ministrave.

Pasqyrat e paraqitura ne raport jane shprehur ne monedhen vendase ne Leke dhe ne euro.

b. Rregullat per vleresimin e kerkesave per arketim dhe te detyrimeve

Kerkesat per arketim jane te pasqyruara mbi bazen e vleres se faturave origjinale te leshuara nga klientet apo te dokumentave te tjere kontabel.

Detyrimet jane njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabel.

c. Rregullat e vleresimit te likujditeteve

Gjendjet e likujditeteve perfshijne gjendjen e parave ne arke dhe ne llogarite rrjedhese ne banke ne leke. U kontrolluan veprimet e kryera ne arke dhe banke dhe u konstatuan se rregjistrimet ne librat e llogarive dhe ne ditaret perkates ishin kryer sipas normave kontabel. Terheqet nga banka perputheshin me hyrjet ne arke.

d. Te Ardhurat

Te ardhurat regjistrohen sipas mases se realizimit te tyre nga dontoret dhe perdorimi i tyre eshte sipas planit te buxhetit te financuar .

ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti eshte i organizuar ne perputhje me ligjin “Mbi Kontabilitetin”.



“KONTALBA AUDITING”
SH.P.K (Semiha Dollani)

Adresa Rr. Muhamet
Gjollesha
Pall. 1/1 Ap.14
Tirane, Albania

Phone: (+355 4) 240 191

Mob: 069 23 90978

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA

PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTIA REPUBLIKANE

Tetor 2009

**SHËNIME
TË
AUDITUESIT TË PAVARUR
MBI
DEKLARIMET FINANCIARE TË PARTISË REPUBLIKANE
PËR
FUSHATËN E ZGJEDHJEVE TË ORGANEVE VENDORE 8 MAJ 2011**

Deklarimet financiare të Partisë Republikane që i përkasin fondeve të siguruara dhe të shpenzuara për fushatën e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore përfshijnë aktivitetin financiar kryesisht të periudhës 31 Mars deri më 8 Maj 2011.

Bazuar në auditimin e kryer, rezulton se të ardhurat janë evidentuar e deklaruar në bazë të arkëtimit faktike, pa përfshirë arkëtimet e pritëshme, duke zbatuar rregullisht parimin kontabël të Kujdesit, ndërkohë që shpenzimet janë evidentuar e deklaruar në përputhje me parimin kontabel të angazhimeve sipas të cilit, ato përfshijnë të gjitha shpenzimet e kryera dhe të njohura pavarësisht nëse janë paguar apo mbeten për t'u paguar në periudha të mëvonëshme. Bazuar në keto parime të kontabilitetit, në llogaritë kontabile e në Pasqyrat financiare të Partisë Republikane është evidentuar e deklaruar si shpenzime për fushatën zgjedhore edhe një faturë e pranuar por e papaguar për shërbimet e përfituara gjatë fushatës elektorale. Kjo mënyrë veprimi është në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të dala në zbatim të tij.

Në këtë kuader konceptual të të ardhurave e shpenzimeve, auditimi u shtri dhe mori në konsideratë edhe ngjarje e fakte ekonomike e financiare që i takojnë fushatës zgjedhore të 8 Majit 2011, pavarësisht se ato kanë ndodhur në periudha jashtë kufirit zyrtar të kësaj fushate i cili është 8 Prill 2011 deri në 8 Maj 2011.

Auditimi i situatës financiare të fushatës zgjedhore të Partisë Republikane mori për bazë deklaratën financiare, regjistrat kontabile si dhe të gjithë dokumentacionin e

nevojshëm, gjë që bëri të mundur krijimin e bazës së opinionit të Audituesit të Pavarur siç spjegohet në vijim.

a.- PËR TË ARDHURAT

Bazuar ne auditimin e kryer rezulton se te ardhurat per fushaten elektorale te Partisë Republikane, sipas burimit te financimit te tyre, perbehen:

Nr	Burimi I financimit te te ardhurave	Shumat ne leke		
		Sipas Raportit Financiar	Sipas auditimit	Diferenca
1	Nga fondet e vetë Partise Republikane	3,550,087	3,550,087	0
2	Nga buxheti i shtetit për fushatën	232,143	232,143	0
3	Nga Donatorët (për fushatën)			0
	- me banke	0	0	0
	- me arke	500,000	500,000	0
	- ne natyre	0	0	0
	Gjithsej te ardhura	4,282,230	4,282,230	0

Të ardhurat e siguruar nga Partia Republikane për të përballuar fushatën e zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore janë deklaruar gjithsej 4,282,230 lekë, dhe nga auditimi rezultoi se Këto të ardhura janë krijuar nga tre burime të ligjshme, si vijon:

1.- Fondet e veta ta Partisë Republikane 3.550.087 lekë, përbejnë pjesën kryesore të burimeve të financimit të fushatës elektorale duke zënë 80.64 për qind të totalit të fondeve të përdorura për këtë fushatë.

Nga kontrolli i fluksit të parasë rezulton se Partisë Republikane, në zbatim të vendimit nr. 177, datë 24.03.2011, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, më datën 28.04.2011 i është akorduar nga buxheti i shtetit fondi 8,101,610 lekë. Një pjesë e këtyre parave në shumën 3.050.587 lekë është evidentuar dhe deklaruar si e ardhur për të përballuar shpenzimet e fushates elektorale për zgjedhjet e 8 Majit 2011 prandaj u përfshi në objektin e auditimit tonë.

Pjesa tjetër e këtij fondi nuk është shpenzuar për fushatën elektorale por mbetet gjëndje në llogarinë bankare nr. 2029031801 te Partisë Republikane pranë Intesa Sanpaolo Bank, për t’u përdorur për nevojat e partisë pas periudhës zgjedhore prandaj nuk përbën objekt të këtij auditimi .

2.- Financime nga buxheti i shtetit për fushatën elektorale të 8 Majit 2011 janë siguruar 232,143 lekë ose 6.14 për qind e fondeve të përdorura gjithsej për këtë fushatë. Këto para janë arkëtuar më datën 28.04.2011, në llogarinë bankare nr. 2029031802 te Partisë Republikane pranë Intesa Sanpaolo Bank, çelur nga Partia Republikane posaçërisht për fushatën elektorale.

3.- Donacione nga shtetas shqiptarë të ndryshëm, për 500.000 lekë përbëjnë burimin e tretë të krijimit të fondeve për fushatën zgjedhore të Partisë republikane, duke zënë 13.22 për qind e fondeve gjithsej të shpenzuara për fushatën zgjedhore. Janë gjithsej 5 dhurues fondesh, shtetas shqiptarë të cilët kane sponsorizuar për fushatën vlera monetare në para si vijon:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Shuma ne leke	Data e dhurimit	Llogaria ku jane derdhur parate
1	Qamil Xhureta	100,000	28.03.2011	Ne arkë
2	Gjergji Miruli	100,000	02.04.2011	Ne arkë
3	Lutfi Pehri	100,000	06.04.2011	Ne arkë
4	Dashnor Pajaziti	100,000	12.04.2011	Ne arkë
5	Olsi Baze	100,000	23.04.2011	Ne arkë
	Shuma	500,000	x	x

Nga verifikimi rezultoi se të gjithë dhuruesit kanë nënshkruar deklaratën e mospasjes konflikt interesi në përputhje me nenin 89 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Te gjithë këta dhurues janë evidentuar dhe deklaruar ne regjistrin e posaçëm , të mbajtur sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Dhurimet janë kryer nëpërmjet arkës së Partisë, pa kaluar më parë në llogarë bankare të posaçme të hapur nga Partia Republikane.

Partia Republikane nuk ka deklaruar ndonjë rast të sponsorizimeve në para nga persona juridike vendas a të huaj apo sponsorizime në natyrë nga ndonjë subjekt dhe as nga verifikimet tona nuk rezultuan të tilla.

b.- PËR SHPENZIMET

Nga verifikimet e kryera rezultoi se shpenzimet për fushatën elektorale të Partisë Republikane, të klasifikuara dhe të grupuara sipas natyrës së tyre janë si vijon :

Nr	E m ë r t i m i	Shumat në leke		
		Sipas Raportit Financiar	Sipas auditimit	Diferenca
a	Shpenzime të paguara			0
1	Reklama e spote televizive	3,290,250	3,290,250	0
2	Parrulla tabela, postera e printime	48,300	48,300	0
3	Flamuj dhe bluza	143,080	143,080	0
4	Qira podesh	54,000	54,000	0
5	Foni, vidio projektore, muzuke etj	235,500	235,500	0
6	Te ndryshme	11,600	11,600	0
	Shuma e shpenzimeve të paguara	3,782,730	3,782,730	0
b	Shpenzime të papaguara			0
1	Reklama, spote televizive	126,189	126,189	0
	Shuma e shpenzimeve të papaguara	126,189	126,189	0
	Gjithsej Shpenzime (a+b)	3,908,919	3,908,919	0

Shpenzimet e fushatës së Partisë Republikane për zgjedhjet e 8 Majit 2011 janë deklaruar gjithsej 3,908,919 lekë, nga të cilat deri në datën e hartimit të këtij Raporti janë paguar 3,782,730 lekë dhe diferenca 126,189 lekë, ndonëse është njohur si shpenzim, nuk rezulton që të jetë paguar brenda kësaj periudhe.

Nga verifikimet rezulton se këto shpenzime nuk e kalojnë kufirin ligjor të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Koha e kryerjes së shpenzimeve në përgjithësi përputhet me afatin zyrtar të fushatës zgjedhore, por një pjesë e tyre janë bërë para fillimit zyrtar të fushatës .

Shpenzimet që nuk janë paguar për 126.189 leke janë të dokumentuara me fature tatimore nr. 71649177 datë 27.04.2011 e cila i përket PLANET TV SHA .

Nga verifikimet tona rezultoi se shpenzimet, në tërësi, janë të dokumentuara me fatura tatimore të cilat janë të evidentuara në pajtim me rregullat dhe standartet kontabile që zbatohen në Shqipëri. Deklarimi i tyre është bërë pa gabime materiale.

Pë të krijuar një opinion më të drejtë, ne i klasifikuam shpenzimet për fushatën e zgjedhjeve sipas natyrës së tyre, në 6 grupe shpenzimesh të cilat spjegohen më hollësisht në vijim .

1. Shpenzimet për Reklama e spote televizive, 3,416,439 lekë zënë pjesën kryesore ose 87,4 për qind të tyre. Nga këto, 3.160.000 lekë janë likujduar tërësisht nëpërmjet llogarise bankare nr. 2029031801 pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe 130.250 leke janë likujduar me para në dorë nga arka e Partisë, ndërsa diferenca 126.189 leke ka mbetur pa u likujduar duke u evidentuar e deklaruar në Kontabilitetin e Partise si Detyrime të Kërkueshme nga Furnitori PLANET TV SHA.

Sipas subjekteve mediatike shpenzimet për **Reklama e spote televizive,** janë :

- Top Channal	2.160.000	lekë
- Media Vizion sha	1.000.000	“
- Rdio + 2 sha.....	30.000	“
- Top Albania sha... ..	100.250	“
- Planet TV SHA.....	126.189	“
Shuma	3.416.439	Lekë

- 6 -

2.- Shpenzimet për materiale publicitare 191.380 lekë, të paguara me para në dorë.
ku janë deklaruar :

- Shpenzime per parrulla, tabela, postera e printime 48.300 lekë,
- Shpenzime per flamuj , bluza etj 143.080 lekë

3.-Shpenzimet për foni,video projektorë e muzikë 235.500 lekë, **Shpenzimet për qira podesh** 54.000 lekë, dhe **Shpenzime të ndryshme** 11.600 lekë, të gjitha këto janë paguar me para në dorë.

Nga verifikimi rezultoi se tërësi këto shpenzime janë kryer në bazë të kontratave të lidhura midis palëve dhe vërtetohen me fatura te rregullta tatimore.

Perfundimisht, bazuar ne auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, kemi shprehur opinionin e Audituesit të Pavarur sipas të cilit Pasqyra Financiare e Te Ardhurave dhe Shpenzimeve te fushatës elektorale të Partisë Republikane jep një pamje të vërtetë e të sigurtë të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore te 8 Majit 2011

Tiranë, më 15 Janar 2012

Ahmet STOJNA

Ekspert Kontabël i Regjistruar
Nr. 6 i Regjistrimit Publik të IEKA-s
Adresa: Rruga e Elbasanit, P."Radovani" Nr.5/5 Tirane
Tel 2468748 Mob 0684040661